

STUDIME TË KUFIRIT: ÇËSHTJA E KUFIRIT ETNIK NGA PERSPEKTIVA E RRËFIMEVE PERSONALE

Arbnora DUSHI

Instituti Albanologjik, Prishtinë, KOSOVË

E-mail: arbnoradushi@hotmail.com

PËRMBLEDHJE

Ndryshimet e mëdha që ndodhën në dhjetë-njëzet vitet e fundit e kanë lëvizur objektin e historisë dhe tani shumë çështje nga e kaluara sikur janë vënë në diskutim. Hapja e kufirit kombëtar i dha rast integritit të shqiptarëve brenda përbrenda kulturës së vet dhe e ktheu historinë dhe traditën kah qenësia e vet, kah tërësia e njëjtë kombëtare. Duke e parë folklorin si një proces të vazhdueshëm si dhe duke e pranuar disiplinën e studimeve të kufirit si një disiplinë të re për interpretimin e dukurive nga tradita, do të përqipem që nëpërmjet rrëfimeve personale gojore të mbledhura nga individë që e përjetuan këtë ndarje në jetën e tyre, të sjell pasojat e kufirit etnik dhe të kësaj drame kombëtare që shkaktoi ai. Nga perspektiva e historisë gojore do të ndriçohet pjesa emotive e historisë sonë dhe shihet folklori si një shkencë në shërbim të shoqërisë dhe ndryshimeve që e përcjellin atë.

Fjalët kyçe: *studime të kufirit, folklor, histori gojore, rrëfim personal, etnicitet.*

HYRJE

Si shqiptarë dhe si popull etnik në trojet tona, ne shqiptarët në Kosovë, jemi të një identiteti kulturor me shqiptarët në Shqipëri. Rrethanat historike na kanë ndarë rajonalisht duke na bërë

t'i takojmë një shteti tjetër, Jugosllavisë. Ndarja e shkaktuar dhunshëm, nëpërmjet një kufiri të ruajtur me forcë të hekurt i cili ka bërë që për pesëdhjetë vite të ndahen familje, ka prodhuar histori të trishtuara të individëve dhe të familjeve. Rrëfimet, dëshmitë, autobiografitë dhe kujtimet e këtyre individëve dhe familjeve që kanë pësuar nga rrethanat e asaj historie janë burime të rëndësishme për përcaktimin e identitetit tonë kulturor e kolektiv si dhe të përcaktimit të vlerave tona të mirëfillta kombëtare.

E intriguar nga lëvizja teorike shumë e përhapur e dekadës së fundit, pra nga fusha e studimeve të kufirit e cila çdo herë e më shumë po gjen zbatim në studimet kulturore, studimet etnike, antropologjia moderne si dhe studimet mbi identitetin, vendosa t'i qasem problemit të krijimeve gojore nga perspektiva e kësaj lëvizjeje teorike.

Puna me zhanrin e rrëfimit personal gojor, ku rrëfimtari apo subjekti gojor shumë herë ofron përjetimin e vet të shkaktuar nga një rrethanë historike, më ngacmoi të kërkoja rrethanën historike dhe më bëri kureshtare të zbuloja më shumë rreth faktit që ofrohej, krahas prodhimit artistik që merrja nga rrëfimtari. Tema e kufirit me Shqipërinë ishte e pashmangshme në rrëfimet e jetës së banorëve të zonave kufitare dhe kjo më bëri t'i afrohem më shumë. Meqenëse kisha të bëja me

kujtesën e të moshuarve, kujtimet e tyre të hershme lidheshin shumë me kohën e Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, kur edhe u vendos ky kufi e prandaj rrëfimet e tyre ishin plot me ngjarje dhe përjetime rreth tij. Për më tepër, tema e kufirit ishte temë tabu për pesëdhjetë vjet dhe prandaj regjistrimi i kujtimeve personale sot do të thoshte mbushje e një zbrastësie me *memorjen e fshehur të komunitetit* dhe zinte vend në të shkruarit e historisë së përgjithshme (Anepaio 2003, 67).

KUFIRI ETNIK NË RRETHANA TË PUSHTIMIT FASHIST GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Ngjarjet historike të cilat e shoqëruan fëmijërinë dhe rininë e rrëfimitarëve të mi, qenë Lufta e Dytë Botërore dhe pushtimet e shteteve fashiste, marrëdhëniet me shtetin shqiptar dhe vënia e kufirit midis Jugosllavisë e Shqipërisë. Këto ngjarje rezultuan me ndërprerjen e menjëhershme të çfarëdo marrëdhënieje njerëzore midis pjesëtarëve të të njëjtit popull. Ata tani do t'i takonin dy shteteve administrative. Do të bënin jetë të ndarë dhe do të zhvilloheshin në rrethana të ndryshme. Të gjitha këto ndryshime u manifestuan në botën emotive të banorëve përreth zonave kufitare, në fatet e tyre personale dhe historitë familjare, të cilat në perspektivë do të prodhojnë kujtesën narrative, atë që në folkloristikë njihet si rrëfimi personal gojor.

Dhuna që kishte ushtruar pushtuesi sllav dhe tmerrri që kishte shkaktuar prania e këtij pushtuesi tek shqiptarët deri në Luftën e Dytë Botërore, bënë që ardhjen e një pushtuesi tjetër, atij nazist gjerman, popullata e pafajshme ta shohë si shpëtim, në fillim vetëm për faktin se kishte arritur t'i largojë sllavët nga Kosova. Rrëfimtari nga Gjakova i lindur më 1924, e kujton kështu ardhjen e pushtuesve të rinj: *Më 6 prill 1941 u bombardua Beogradi, në mëngjes herët, dhe kështu u sulmua Jugosllavia. Për dy javë ajo u dorëzua. Kështu u hoq kufiri Shqipëri-Kosovë. Me të thanë të drejtën ne populli i Gjakovës e kemi pritur me padurim rënien e Jugosllavisë së vjetër sepse ishim të shtypur ekonomikisht, në pikëpamje të arsimit e në çdo formë tjetër. Madje më kujtohet në prill 1941 Radio Londra ku emisionin në gjuhën shqipe e përgatiste Tajar Zavalani, dhe kush kishte radio kishte mundësi ta përcillte... Më kujtohet më 6 prill ishte e*

dielë dhe nëpërmjet Radio Londrës u lajmërua popullsia e Gjakovës se gjermanët sulmuan Jugosllavinë. Të nesërmen gjermanët kishin arritur nga Bullgaria në Prizren. Më kujtohet shumë mirë që thanë se gjermanët kanë ardhur në Prizren e të nesërmen do të hyjnë edhe në Gjakovë. Popullsia ishte shumë e gëzuar që po shkatërrohej Jugosllavia. Unë atëherë i kisha pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetë vjet dhe më kujtohet që patëm dalë t'i presim gjermanët si çlirues. Mirëpo ushtria jugosllave e kishte pasë shkatërruar Urën e Fshejt kështu që gjermanët kanë ardhur deri aty e pararojat e tyre, dy veta që i paraprijnë ushtrisë me motoçikleta, kanë arritur në lumin Dri dhe janë kthyer se nuk kanë qenë të përgatitur për ta kaluar ujin. Atëherë ne u shpërndamë dhe filluan torturat e serbo-malazezëve në popullatën e Gjakovës. Ishin këta që sot i quajnë paramilitarë e atëherë u thonin dobrovoljca – serbisht vullnetarë. Atëherë i patën vrarë 10-12 veta në Gjakovë (rrëfimtari 2, 81 vjeç, Gjakovë).

Largimi i forcave sllave nga Kosova u pa si liri e plotë për banorët dhe në fillim të ardhjes së forcave gjermane, përkundër zhvillimeve politike dhe planeve të Fuqive të Mëdha, populli në terren i ka parë si çlirues, se u kanë dëbuar një pushtues paraparak, i cili madje edhe në tërheqje s'ka kursyer asgjë për të shkatërruar.

Për shqiptarët gjermani është parë shpëtues edhe për një fakt tjetër. Ardhja e nazistëve gjermanë krijoi mundësinë të hapen me Shqipërinë, shtetin e tyre kombëtar me të cilin i kishin kontaktet e ndërprera në kohën e sllavëve. Prandaj para një të mire që u ka sjellur gjermani – bashkimin me Shqipërinë, shqiptarët në fillim, nuk kanë mundur të shohin të keqen e madhe – fashizmin, që po e mbillte ai. Një rrëfimtare, atëherë nxënëse, kështu e kujton hapjen e komunikimit me Shqipërinë:

Me ardhjen e gjermanëve, të cilët e morën Gjakovën në dorëzim, nuk shkoi shumë kohë ndoshta pak më shumë se një javë, erdhën këta nga Shqipëria. Kush erdhi? Erdhën mësuesit, ushtarakët, oficerët shqiptarë, njerëzit që kanë jetuar me vite në Shqipëri e që nuk kanë guxuar të vijnë në Kosovë se atëherë ka qenë i mbyllur kufiri dhe kush është zënë të kufiri është vrarë. Ka qenë viti 1939 apo 1940, nuk po më kujtohen datat e sakta. E di që ka qenë verë dhe ka qenë nxehtë kur dolëm t'i presim këta mësuesit e parë. (...) I kemi dashur. Për herë të parë na mblodhën në shkollë neve nxënëseve,

pesëdhjetë a njëqind a sa ishim, na mblodhën që të na tregonin për mësimin shqip. Ne që kishim shkuar në shkollë i kishim mësuar edhe germat latine dhe dinim të lexonim edhe shqip. Na mblodhën në sallën lart dhe njëri nga ta hipi në një karrige që të na mësojë himnin e flamurit (rrëfimtaria 6, 75 vjeç, Gjakovë).

Me ardhjen e gjermanëve e më vonë edhe italianëve të cilët shpejt u bënë aleatë në pushtimin fashist të Ballkanit, Kosova u copëtua midis Italisë e Gjermanisë si edhe Bullgarisë që mori një pjesë të Kosovës lindore bashkë me Kaçanikun. Pjesa më e madhe e Kosovës, e banuar me shqiptarë, iu dha Italisë duke iu dhënë mundësia të bashkohej me Shqipërinë përdërisa Mitrovicën me xeheroret e Trepçës si dhe Vuçiternën i mori Gjermania për interesa të përfitimit ekonomik. Fashistët bënë përpjekje të mirëfillta për ta përhapur arsimimin në gjuhën shqipe duke hapur afër dyqind shkolla fillore (Malkolm 2001, 305). Këto zhvillime politike u manifestuan dukshëm në shpirtin e popullatës shqiptare e cila deri atëherë kishte qenë e mohuar në pikëpamje kombëtare, arsimore, ekonomike e të standardit të jetës në përgjithësi. Liria e të shprehurit të identitetit kombëtar luajti rol të madh në zgjimin kombëtar dhe ngritjen e vetëdijes së njerëzve, e cila u manifestua nëpërmjet arsimimit, prandaj edhe të gjithë e kujtojnë me nostalgji dhe adhurim këtë periudhë të Luftës së Dytë Botërore.

Si hynë forcat gjermane në Jugosllavinë e atëherëshme, në Kosovë dhe në Gjakovë (në Gjakovë kanë hyrë në fund) u hap kufiri me Shqipërinë dhe erdhën intelektualët shqiptarë. Një pjesë e madhe e tyre kanë qenë gjakovarë, të cilët edhe e hapën shkollën shqipe. Kur e hapën shkollën ka qenë fundi i prillit apo fillimi i majit të vitit 1941. Unë shkova dhe u regjistrova në klasën e pestë fillore në gjuhën shqipe (rrëfimtari 1, 77 vjeç, Gjakovë).

Hapja e kufirit me Shqipërinë kishte edhe leverdi ekonomike pasi u zhvillua edhe tregëtia dhe një numër i madh i banorëve të qyteteve të Kosovës perëndimore e jug-perëndimore, të cilët që në kohën e Zogut në Shqipëri kishin filluar rrugët e tregtisë nëpërmjet Shqipërisë për në Itali, tanimë po e forconin rrjetin e tregëtisë. Shumë kryefamiljarë të cilët patën filluar tregëtinë duke hapur ndonjë dyqan në qytetet shqiptare, Krumë

e Kukës, tanimë morën edhe familjet dhe e krijuan një bashkësi të kosovarëve në Shqipëri. Rrëfimtaria nga Prizreni, burri i së cilës ka qenë tregëtar në Kukës, bashkë me shumë kosovarë të tjerë nga Gjakova e Prizreni, të cilët kishin shkuar atje për një standard më të mirë jetese, për çka më vonë e kishte tërhequr edhe familjen, rrëfen:

Kukësi, ka qenë shumë i mirë. Kemi bërë shumë sefa në Kukës atëherë. Burrat punonin dhe fitonin shumë. I kanë pasë dyqanet e mira, të mbuluara me dërrasa, pa tjegulla, por punë ka pasur shumë. Atëherë, burrat punonin dhe bënë pasuri e ne gratë hanim mirë, visheshim mirë, mbanim ndihmës në shtëpi, një femër dhe një mashkull, që të na ndihmonin në punët e shtëpisë. E kemi pasur një shërbyes, axhën Murat, që ishte nga Prizreni, i cili punonte në shtëpinë tonë. Puna e tij ishte të vinte gjatë ditës nga dyqani dhe të shihte a kemi nevojë për ushqime e për shërbime të tjera ditore. Gatuanim atëherë bukë se ishin mallërat e mira. Mielli e bënte bukën shumë të mirë. Fryheshin bukët e dilnin të bardha. Më bardhë se bora. Tëlyni na vinte me teneqe, me kilogramë. Sheqeri e të gjitha të mirat (rrëfimtaria 7, 90 vjeç, Prizren).

Një standard i këtyllë jetese mund të realizohej në një vend me largësi vetëm 30 kilometra nga Prizreni. Në Kukës, shqiptarët e Kosovës që kishin shkuar për të jetuar kishin të njëjtën gjuhë e kulturë me vendasit dhe për ta jetesa atje nuk konsiderohej shpërngulje apo mërgim, pasi që qytetet veriore të Shqipërisë dhe ato jug-perëndimore të Kosovës për banorët e këtyre anëve konsideroheshin të një tërësie gjeografike. Faktikisht përfaqësonin të njëjtën zonë etnografike.

KUFIRI, PENGESË DHE DËSHIRË PËR TA KALUAR NJËKOHËSISHT

Liria e lëvizjes dhe kalimi i lehtë i kufirit nuk ka qenë gjithmonë e njëjtë, pasi kjo çështja e hapjes së tij ishte çështje e brishtë dhe ndryshonte nga situata politike, e si e tillë ajo është manifestuar menjëherë në përvojat personale. Dëshira për lidhjen dhe kontaktin me Shqipërinë ka qenë e pranishme gjithmonë te popullata e këtyre qyteteve dhe fshatrave të cilat gjendeshin në zonën kufitare. Si në kohën e mundësisë për të shkuar atje ashtu edhe në periudhat e pamundësisë së kontaktit me Shqipërinë, ndjenja për të qenë bashkë dhe të lidhur

me shtetin shqiptar, ka qenë shumë e fuqishme dhe është manifestuar, nëse shprehem në mënyrë simbolike, sikur të merret pa dëshirë diçka nga vetja dhe pastaj gjithmonë do të të mbytë dëshira për ta kthyer në vend. Edhe bindja e vazhdueshme që del nga këto rrëfime se në Shqipëri njerëzit kanë qenë më të kulturuar, se atje ka qenë malli me bollëk, se arsimin e kanë pasë më të fortë, se mësuesit që kanë ardhë prej atje kanë qenë më të mirë, se atje ka pasur rend e rregull etj., shpjegohet me lakminë dhe dëshirën e vazhdueshme për të qenë bashkë me Shqipërinë. Madje te rinia e kësaj ane, për një kohë të gjatë edhe pasi është mbyllur kufiri, ka ekzistuar dëshira e fortë për të kaluar kufirin ilegalisht, qoftë edhe me rrezikun e jetës. Rrëfimtaria tregon: ...*Atëherë të rinjtë kishin dëshirë të iknin në Shqipëri, shumë kishin dëshirë. ...E pse kishin dëshirë të rinjtë të shkonin atje? Po ku e di unë, kishin dëshirë. Donin të shkonin atje ku ishin të gjithë shqiptarë. Donin të vazhdonin shkollën në gjuhën e vet* (rrëfimtaria 9, 84 vjeç, Gjakovë).

Fati jetësor i shumë të rinjve të këtyre anëve, në periudhën e vendosjes së kufirit politik midis Jugosllavisë dhe Shqipërinë, me ç'rast Kosova si tokë shqiptare e banuar me shqiptarë, kishte mbetur nën Jugosllavi, është i lidhur me Shqipërinë. Pamundësia për të kaluar në anën e Shqipërisë e ka shtuar edhe më tepër dëshirën e tyre dhe prandaj dëshira dhe synimi për të kaluar kufirin ka qenë e pranishme dhe e fuqishme te shumë të rinj dhe për një numër jo të vogël të tyre ka qenë fatale, u ka kushtuar me humbje të jetës në rrethana të mistershme.

PËRFUNDIM

Në Kosovë që është edhe zona verilindore e Shqipërisë, e cila mbeti jashtë kufijve të saj, gjenden dy qytete të zonës kufitare, Gjakova dhe Prizreni, ku jeta e përgjithme e banorëve të kësaj ane është e lidhur me kufirin që e ka ndarë Kosovën me Shqipërinë. Përgjatë tërë historisë së kësaj zone, ardhjet e pushtuesve të ndryshëm, janë manifestuar në popull varësisht nga qëndrimi që kanë pasur ata ndaj këtij kufiri. Kujtesa e popullit e shprehur nëpërmjet rrëfimeve per-

sonale që kam mbledhur nga banorët e moshuar të këtyre qyteteve, ku shprehin jetën e vet, kujtimet e fëmijërisë, rinisë dhe pleqërisë, e ka të pashmangshme temën e kufirit, pasi ajo është manifestuar në cilindo raport që kanë ndër-tuar këta banorë. Është manifestuar në raportet familjare kur është dashur të vizitojnë të afërmit që jetonin matanë kufirit, në raportet me punën kur në kohën e mbretit Zog tregëtia që zhvillohej në Shqipëri ishte e lakmueshme për çdo shqiptar të Jugosllavisë, në raportet me shkollimin kur matanë kufirit mësimi zhvillohej në gjuhën amëtare e shqiptarët në Jugosllavi ishin të detyruar të shkolloheshin në gjuhë të huaj, në raportet me pushtetin ku shqiptarët në Jugosllavi ndiheshin të trajtuar keq nga pushteti që nuk ishte i tyre etj. Të gjitha këto raporte kanë arritur të shtresohen në shpirtin e banorëve të zonave kufitare dhe të krijojnë rrëfime shumë të fuqishme të jetës së tyre personale. Zbardhja e historisë nëpërmjet kujtesës së atyre që e kanë krijuar atë histori, ofron mundësi të reja të humltimeve dhe studimeve për folklorin dhe historinë e shqiptarëve.

BIBLIOGRAFIA

- ANEPALIO, T. Boundaries in the Soviet Union, Making and Breaking of Borders, *Studia Fennica Ethnologica* 7, Finnish Literature Society, Helsinki, 2003.
- BEN-AMOS, D. Toward a Definition of Folklore in Context, *The Journal of American Folklore*, vol. 84, no. 331, Austin: University of Texas Press, 1971.
- DUSHI, A. Albanian Folklore, *Encyclopedia of World Folklore and Folklife III*, Greenwood Publishing House, Westport, Connecticut, 2006.
- GRUP AUTORËSH, *Gjeografia e Kosovës*, ETMMK, Prishtinë, 1994.
- MALKOLM, N. *Kosova - një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001.
- VASENKARI, M. & ARMI, P., A path to an understanding, *Studia Fennica Ethnologica* 5, Helsinki 1999.

BURIMET e papublikuara

Materialet e transkriptuara nga intervistat e realizuara më 2005 në qytetet Gjakovë dhe Prizren, të cilat janë pjesë e projektit "Rrëfimi personal gojor si një lloj i krijimtarisë gojore". Këto materiale janë pronë e Arkivit të Institutit Albanologjik të Prishtinës.